



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:072145

Datë: 17.10.2019

Numri i dokumentit: 00585086

**P.nr.196/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. C. nga fshati G. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1-9/2019, të datës 28.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Prokurorit të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit R. C. dhe mbrojtësit të tij M. Q. Avokat nga Prizreni, me datë 15.10.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 16.10.2019 e përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari R. C.**, nga i ati R. dhe e ëma R. C. e lindur S., i lindur me 13.01.1984, në fshatin G. Komuna e Suharekës, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së dobët ekonomike, ka qen në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.01.2019 deri më 02.02.2019

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 02.01.2019, rreth orës 17:00, në rrugën e fshatit S., Komuna e Suharekës, saktësisht përball lokalit afarist – lulishtes “F.”, i pandehuri derisa drejtonte automjetin e markës dhe tipit “R. K.”, me targa të regjistrimit 04-...-GN, ngjyrë hiri, vepron në kundërshtim me nenin 53 dhe 151 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor dhe nga pakujdesia, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që kur arrin në vendin kritik, nuk ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë pasi që edhe ishte vendbanim edhe në rastet kur rruga kalohet nga personat e moshuar shoferi detyrohet ta ndal automjetin në mënyrë që t’ua mundësoj personave ta kalojnë rrugën, duke mos e vërejtur praninë e këmbësorit i cili ishte duke trupuar rrugën nga ana e majtë për në anën e djathtë të rrugës dhe gjatë kalimit të rrugës kur arrin në përfundim të kalimit të rrugës në ato momente goditet me pjesën e përparme të automjetit të anës së djathtë, gjegjësisht me parafango dhe pas goditjes të njëjtin me pjesën anësore të anës së djathtë e hedh në anën e djathtë dhe ndalet para vijës së pasme të mjetit të ndaluar, si pasojë e së cilës i dëmtuari-tani i ndjeri S. H. merr lëndime trupore të cilat janë edhe vdekje prurëse dhe më pas ekipi i mjekëve kujdestar konstaton edhe vdekjen e tij.

Me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 të KPK-së.

Pranohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.1-9/19 e dt. 19.09.2019 e lidhur mes prokurorit të Shtetit - Prokurorisë Themelore në Prizren e nënshkruar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore dhe prokurori i çështjes në njërën anë dhe të akuzuarit R. C. dhe mbrojtësit Av.M. Q., në anën tjetër.

Gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 45, 62, 47, 73, 74, 75, 76 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

### **DËNIM ME BURGIM**

Në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim i zëvendësohet me **dënim me gjobë** në shumë prej **4000 (katërmijë) euro**, në të cilin dënim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 02.01.2019 deri me datë 02.02.2019, i cili dënim duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

### **DËNIM PLOTËSUES**

Ndalimi i drejtimit të automjeteve të kategorisë “B” në afat prej një viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit të paguaj shumë prej 40.88 euro, në emër të shpenzimeve të ekzaminimit në vendin e ngjarjes në shumë prej 20.44 euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30 euro si dhe për paushallin gjyqësor të paguajnë shumë prej 40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Perfaqesuesi ligjor i te ndjerit, B. H., për realizimin e kërkeses pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1-9/2019, të datës 28.01.2019, kundër të akuzuarit R. C. nga fshati G. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), aktakuzën të cilën gjatë seancës gjyqësore, në rigjykim, e ka përfaqësuar PSH Besim Susuri, i cili në tërësi ka ngelë pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, në përputhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila i është bashkangjitur aktakuzës.

I akuzuari ka lidhur marrëveshjen për pranimin e fajësisë në prokurori me numër PP/II.nr.1-9/2019 të dt.19.09.2019 në prezencën e mbrojtësit Av.M. Q., dhe në seancë qëndron në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

I akuzuari gjithashtu në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë ka deklaruar se ka qenë i vetëdijshëm, i informuar me benificionet dhe pasojat e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe se me vullnetin e lirë në prani të mbrojtjes e ka nënshkruar të njëjtën dhe ka heqë dorë nga një gjykim i rregullt, ku do të administroheshin provat, në shkëmbim të një dënimi më të butë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.15.10.2019 dëgjoi palët ku PSH ngeli si në aktakuzë dhe kërkoi nga gjykata të aprovoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënimin e propozuar në marrëveshje të rekomanduar në pikën IV të marrëveshjes, pasi që marrëveshja është nënshkruar me vullnetin e palëve dhe është në përputhje me nenin 233 pika 18 e KPP-së.

I akuzuari gjithashtu kërkoi që gjykata të aprovon marrëveshjen dhe ti shqiptoj dënimin e rekomanduar në pikën IV të saj.

Gjykata ka vlerësuar që marrëveshja të pranohet pasi që e njëjta është në përputhje edhe me provat materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës nga Prokuroria e Shtetit dhe se e njëjta nuk është në kundërshtim me paragrafin 18 të nenit 233 të KPP-së dhe ka shqiptuar dënimin e rekomanduar si në marrëveshje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**P.nr.196/2019 të dt. 16.10.2019**

**Bashk.Profesional**  
**Feim Bytyqi**

**Gjyqtari**  
**Qemail Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:072145  
Datë: 17.10.2019  
Numri i dokumentit: 00585086